

Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj

Raportimet Financiare për tremujorin I 2024 për
Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Prill 2024

Pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	
Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K5192800II
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	1
Adresa	Rruga Tish Daija,Kompleksi Kika2,Tirane
Telefon/fax	+355 694040481
Email:	Alketa.gjocaj@raiffeisen.al
Faqe Web	www.raiffeisen-invest.al
Data e licensimit	18 Tetor 2010
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Donalda Gjorga - Kryetare Peter Zilinek-Zv.Kryetar Erjon Balli-anëtar Elona Llaci-anëtare Gentjana Ciceri-anëtare Alketa Emini-anëtare Edlira Konini-anëtare
Pesë aksionerët më të mëdhenj (emri,mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	Raiffeisen Bank Albania
Adresa zyrtare	Rruga e Kavajes
Përqindja e aksioneve	100%
Numri i punonjësve	15
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	Deloitte Audit Albania Sha
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administrimit	First Investment Bank, Albania
Numrat e llogarive:	
Nr e llogarive të Shoqërisë Administruese:	
Raiffeisen Bank	AL75 2021 1037 0000 0000 0095 9145
Raiffeisen Bank	AL34 2021 1013 0000 0001 0495 9145
First Investment Bank Albania	AL18 2151 1031 ALL1 0000 0401 7500
Nr e llogarive të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen:	
First Investment Bank Albania	AL78 2151 1031 ALL1 0000 0393 3000
First Investment Bank Albania	AL93 2151 1031 ALL5 3000 0393 3000
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj:	
First Investment Bank Albania	AL43 2151 1031 ALL1 0000 0524 4100
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro:	
First Investment Bank Albania	AL03 2151 1031 EUR1 0000 0610 6600
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Vizion:	
First Investment Bank Albania	AL60 2151 1031 ALL1 0000 1172 3200
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Miks:	
First Investment Bank Albania	AL32 2151 1031 EUR1 0000 1473 1900

Pasqyrat financiare të fondit të investimit Raiffeisen Prestigj

1. Pasqyra e asetëve të fondit Prestigj

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-BI**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

	Lek	Lek
Zërat e aktivitetit	31/12/2023	31/03/2024
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare , depozite	5,101,386,592.77	5,439,499,116.78
2. Investime (2a+2b+2c+2d+2d)	25,629,735,541.26	26,770,776,796.69
2a. Letra borxhi të blera në emetimin e parë	24,117,108,767.08	25,546,658,114.93
2a.1 Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet te ardhurave gjithpërfshirëse	24,117,108,767.08	25,546,658,114.93
2a.3 Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2b. Letra borxhi të blera në treg sekundar	1,512,626,774.18	1,224,118,681.76
2b.1 Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet te ardhurave gjithpërfshirëse	1,512,626,774.18	1,224,118,681.76
2b.3 Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2c. Depozita		
3. Llogari të arkëtueshme	349,995,185.49	208,670,178.96
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme	349,995,185.49	208,670,178.96
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	31,081,117,319.52	32,418,946,092.43
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	30,107,958.39	31,344,298.67
7. Detyrime ndaj depozitarit	1,701,754.16	1,771,634.28
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë (shlyerje)	14,108,101.26	30,530,019.39
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera	10,384,489.30	9,091,312.49
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I PËRGJEGJËSIVE	56,302,303.11	72,737,264.83
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË INVESTIMIT	31,024,815,016.41	32,346,208,827.60
D Numri i kuotave të fondit të investimit të emetuara	19,237,104.1275	19,832,859.5288
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT	1,612.7591	1,630.9402

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të investimit Raiffeisen Prestigj

Emri i fondit të investimit: *Raiffeisen Prestigj*

Kodi i fondit të investimit: *FI-B1*

Emri i shoqërisë administruese: *Raiffeisen Invest*

Për periudhën: *31/03/2024*

		31/03/2023	31/03/2024
Nr.	Zerat		
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	4,585,027.80	9,473,343.70
2	Të ardhura nga interesat	293,270,890.14	275,007,448.29
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Të ardhura të tjera		56,215.16
A (1+2+3+4+5)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	297,855,917.94	284,537,007.15
	SHPENZIMET		
6	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë		69,557,821.80
7	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
8	Tarifa për shoqërinë administruese	73,485,517.00	90,535,409.68
9	Tarifa për depozitarin	4,153,526.47	5,215,007.95
10	Shpenzime të tjera	32,426,973.39	4,396,562.21
B (6+7+8+9+10)	TOTALI I SHPENZIMEVE	110,066,016.86	169,704,801.64
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	187,789,901.08	114,832,205.51
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e perealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-	23,083,258.73	51,138,391.75
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë		
d3	Amortizimi i primit/diskontit të aktiveve te vlefshme per shitje		
d4	Zhvlerësim i aktiveve		-1,654,396.29
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-	23,083,258.73	49,483,995.46
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	210,873,159.81	164,316,200.97
F	TE ARDHURA GJITHPERFSHIRESE		
	Zërat që mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje:		
a)	Letra te vlefshme per shitje:		
	Fitimet / humbje që lindin gjatë vitit	1,055,556,338.84	190,768,420.13
b)	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
	TOTALI I TE ARDHURAVE GJITHPERFSHIRESE	1,055,556,338.84	190,768,420.13

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

		Lek	Lek
		31/12/2023	31/03/2024
	Zërat		
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-	911,029,980.26	114,832,205.51
2	Totali i fitimeve (humbjeve) të përcaktuara nga investimet në letra me vlerë, +/-	28,686,310.90	49,483,995.46
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare me vlerë të drejtë ndërmjet të ardhurave gjithpërfshirëse	773,744,961.54	190,768,420.13
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	1,713,461,252.70	355,084,621.10
4	Kontribute nga anëtarët e fondit	9,970,744,557.31	2,471,217,529.07
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë	-	-
6	Tërheqje për pagesat e përfitimeve / tërheqje nga fondi	6,670,706,069.19	1,504,908,338.98
B (4-5-6)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT , +/-	3,300,038,488.12	966,309,190.09
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-	5,013,499,740.82	1,321,393,811.19
D	AKTIVET NETO		
7	Në fillim të periudhës	31,024,815,016.41	31,024,815,016.41
8	Në fund të periudhës	36,038,314,757.24	32,346,208,827.60
	NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË INVESTIMIT		
9	Kuota të investimit të emtuara mbi bazën e investimeve	6,212,031.53	1,523,915.14
10	Kuota të investimit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (kalim te fondi Vizion)	0.00	0.00
11	Kuota të investimit të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve/ shlyerje	4,197,196.95	928,159.74
E (9-10-11)	NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT	2,014,834.58	595,755.40

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit Prestigj

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Lloji	Numri i kuotave të fondit	Aktivet e fondit (Lek)	Aktive për kuotë (Lek)
Në fillim të periudhës 31/12/2023	19,237,104.13	31,024,815,016.41	1612.7591
Emetuar gjatë periudhës	1,523,915.14	2,471,217,529.07	1621.6241
Tërhequr për shkak të largimit nga fondi	928,159.74	1,504,908,338.98	1621.3894
Në fund të periudhës 31/03/2024	19,832,859.53	32,346,208,827.60	1630.9402

5. Pasqyra e strukturës së investimeve

5.1 Obligacionet

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek) 01/01/2024	Vlera në datën e raportimit (Lek) 31/03/2024	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)	19,029,100,000.00	18,835,538,324.90	15,512,543,146.20	18,835,538,324.90		58.10%
AFS	19,029,100,000.00	18,835,538,324.90	15,512,543,146.20	18,835,538,324.90		58.10%
Primar	17,779,400,000.00	17,611,419,643.14	15,304,465,146.22	17,611,419,643.14		54.32%
Secondar	1,249,700,000.00	1,224,118,681.76	208,077,999.98	1,224,118,681.76		3.78%
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)						
TOTALI OBLIGACIONEVE TE EMETUESVE VENDAS	19,029,100,000.00	18,835,538,324.90	15,512,543,146.20	18,835,538,324.90		58.10%
Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)						
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)						
TOTALI OBLIGACIONEVE TE EMETUESVE TË HUAJ						

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek) 01/01/2024	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Bono të thesarit (brenda vendit)	8,089,270,000	7,884,100,080	6,352,624,015	7,935,238,472	24.48%
AFS	8,089,270,000	7,884,100,080	6,352,624,015	7,935,238,472	24.48%
Primar	8,089,270,000	7,884,100,080	6,352,624,015	7,935,238,472	24.48%
Letra me vlerë të tjera (brenda vendit)	-			-	-
TJERA ME VLERË TË EMETUESVE VENDAS	8,089,270,000	7,884,100,080	6,352,624,015.11	7,935,238,472	24.48%
Bono të thesarit (jashtë vendit)					
TJERA ME VLERË TË EMETUESVE HUAJ					

5. Pasqyra e strukturës së investimeve
5.3 Investime të tjera

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (brenda vendit)	5,439,499,116.78	16.78%
Aktive të tjera (brenda vendit)		
TOTALI BRENDA VENDIT	5,439,499,116.78	16.78%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (jashtë vendit)		
Aktive të tjera (jashtë vendit)		
TOTALI JASHTË VENDIT		

6. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara te fondit

Emri i fondit të pensionit: *Raiffeisen Prestigj*

Emri i shoqërisë administruese: *Raiffeisen Invest*

Për periudhën: 31/03/2024

Data e shitjes	Instrumentet Financiare	Kategoria e asetëve financiare sipas IAS 39	Shuma apo Vlera nominale (Lek)	Vlera kontabel e drejte (Lek)	Vlera e shitjes dhe maturuar	Fitimi (Humbja) e realizuar (Lek)
1	2	3	4	5	6	7 (6-5)
	Aksione te zakonshme					
	Aksione preferenciale					
	Aksione te shoqerive te investimit					
	Obligacione qeveritare		3,464,200,000.00	3,456,464,741.90	3,391,828,753.44	-64,635,988.46
	Obligacione bashkiake					
	Obligacione te shoqerive					
	Boni thesari		600,000,000.00	595,448,489.63	600,000,000.00	4,551,510.37
	Emetime te bankes qendrore					
	Deftesa tregtare					
	Kouta te fondeve te investimit					
	Letra te tjera me vlere					
	Letra me vlere te strukturuara me vlere te drejte					
	Letra me vlere te strukturuara me derivate te perfshira					
	Instrumente derivate					
	Totali i fitimit (humbjes) se realizuar		4,064,200,000.00	4,051,913,231.53	3,991,828,753.44	-60,084,478.09

	Ripermbledhja sipas kategorive te asetëve financiare		4,064,200,000.00	4,051,913,231.53	3,991,828,753.44	-60,084,478.09
	Fitimi (humbje) te realizuara nga astete financiare me vlere te drejte					
	Fitimi (humbje) te realizuara nga astete financiare te ndërmjet te ardhurave gjithperفشirese		4,064,200,000.00	4,051,913,231.53	3,991,828,753.44	-60,084,478.09
	Fitimi (humbje) te realizuara nga astete financiare te mbajtura ne maturim					

Kategorizimet jane ne perputhje me IAS 39

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të parealizuara te fondit

Emri i fondit të pensionit: *Raiffeisen Prestigj*

Emri i shoqërisë administruese: *Raiffeisen Invest*

Për periudhën: *31/03/2024*

Data e shitjes	Instrumentet Financiare	Kategoria e asetëve financiare sipas IAS 39	Vlera e tregut (Lek) 01.01.2024	Vlera kontabel e drejte (Lek)	Fitimet(humbjet)e parealizuara te njohura drejperdrejti permes fitimit(humbjes)	Amortizimi i zbritjes(primit) per asetet me maturim fix
	Aksione te zakonshme					
	Aksione preferenciale					
	Aksione te shoqerive te investimit					
	Obligacione qeveritare		18,835,538,325	18,835,538,325	0.00	
	Obligacione bashkiake					
	Obligacione te shoqerive					
	Boni thesari		7,884,100,080	7,935,238,472	51,138,392	
	Emetime te bankes qendrore					
	Deftesa tregtare					
	Kouta te fondeve te investimit					
	Letra te tjera me vlere					
	Letra me vlere te strukturuara me vlere te drejte					
	Letra me vlere te strukturuara me derivate te perfshira					
	Instrumente derivative					
	Totali i fitimit (humbjes) se realizuar		26,719,638,405	26,770,776,797	51,138,392	0.00
	Ripermbledhja sipas kategorive te asetëve financiare		26,719,638,405	26,770,776,797	51,138,392	0.00
	Fitimi (humbje) te parealizuara nga astete financiare me vlere te drejte					
	Fitimi (humbje) te parealizuara nga astete financiare te ndërmjet te ardhurave gjithperfshirese		26,719,638,405	26,770,776,797	51,138,392	0.00
	Fitimi (humbje) te parealizuara nga astete financiare te mbajtura ne maturim					

Kategorizimet jane ne perputhje me IAS 39

8. Pasqyra e fluksit te parasë

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Prestigj**

Kodi i fondit të investimit: **FI-BI**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Gjendja	Lek
	31/03/2024
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI	1,598,223,795.10
Hyrje nga shitja e asetëve afatgjata (T-Bonds)	3,798,170,565.94
Dalje për blerjen e asetëve afatgjata (T-Bond)	-2,837,697,175.85
Hyrje nga interesat në llogari rrjedhese	
Dalje për pagime interesash	
Hyrje nga investimi në instrumente borxhi dhe llogari të arkëtueshme	43,055,332,259.44
Dalje për shkak të investimit në instrumente borxhi dhe llogari të arkëtueshme	-40,770,547,091.71
Hyrja nga investimi në asete financiare afatshkurter (T-bills)	600,000,000.00
Dalje për investimin në asete financiare afatshkurter (T-Bills)	-2,126,924,554.54
Hyrje nga shoqëria administruese	
Dalje për pagimin e tarifave të shoqërisë administruese	-89,299,069.40
Hyrje nga depozitari	
Dalje për pagimin e tarifave të depozitarit	-5,047,338.73
Dalje për kosto transaksionesh	-97,789.10
Dalje për pagim taksash	-20,358,567.69
Hyrje të tjera nga aktiviteti	
Dalje të tjera nga aktiviteti	-5,307,443.26
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT	1,002,709,143.87
Hyrje nga emetimi i kuotave	2,471,718,774.87
Dalje për shlyerjen e kuotave	-1,469,009,631.00
Dalje për pagesat për kuotambajtesit për ndarjen e fitimeve	
Hyrje të tjera nga aktiviteti i financimit	
Dalje të tjera nga aktiviteti i financimit	
EFEKTET E NDRYSHIMIT NË KURSET E KEMBIMIT	
RRITJA (ZBRITJA) NETO NË FLUKSIN E PARAVE	2,600,932,938.97
GJËNDJA E PARAVE NË FILLIM TË PERIUDHËS	43,582,789.45
GJËNDJA E PARAVE NË FUND TË PERIUDHËS	2,644,515,728.42

9. Raporti i transaksioneve me palët e lidhura

Emri i fondit të pensionit: **Raiffeisen Prestigj**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Emri i palës së lidhur	Përshkrimi i transaksionit	Data e transaksionit	Shuma ose vlera nominale	Kosto e blerjes	Vlera e transaksionit	Fitimi (humbja e realizuar)
Shoqëria e administrimit	Tarife administrimi				90,535,409.68	
Sipërmarrje investimi e administruar nga shoqëria administruese						
Depozitari	Tarife depozitari				5,117,218.85	
	Tarifa per transaksione				97,789.10	
Konsulent taksash/ekspert kontabël						
Institucion krediti apo investues						

10. Raporti mbi pozicionet që rrjedhin me palët e lidhura me sipërmarrjen e investimeve

Emri i fondit të pensionit: **Raiffeisen Prestigj**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/03/2024**

Emri i palës së lidhur	Asetet	Detyrimet	Të ardhurat	Shpenzimet
Shoqëria e administrimit		31,344,298.67		90,535,409.68
Sipërmarrje investimi e administruar nga shoqëria administruese				
Depozitari	2,644,515,728.42	1,771,634.28	105,507.41	5,215,007.95
Firmë ligjore				
Konsulent taksash/ekspert kontabël				

1. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 10198 datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 179, datë 13/12/2011, licensoi Shoqërinë Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a për të kryer veprimtarinë e administrimit të asetëve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, krahas veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar (Licenca nr.1, datë 13.12.2011).

Gjithashtu, me Vendimin nr. 180, datë 13.12.2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi Fondin e Investimit Raiffeisen Prestigj (Kodi FI-B1), nën administrimin e Raiffeisen Invest sh.a.

Raiffeisen Invest sh.a aktualisht administron kater fonde investimi “Raiffeisen Prestigj”, “Raiffeisen Vizion”, “Fondi Raiffeisen Miks”, si dhe “Raiffeisen Invest Euro”, të cilët nuk janë entitete ligjore dhe nuk kanë personalitet juridik.

Mbështetur në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj. Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit Raiffeisen Prestigj.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe raportuese.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në këto pasqyra financiare.

• Aktivet dhe detyrimet financiare

Fondi klasifikon aktivet financiare në kategoritë: me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, të mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe llogari të arkëtueshme.

i Njohja

Aktivitetet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti behet pale kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si data kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i lëvizet entitetit. Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) c' regjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai lëvizet/dergohet nga entiteti. Kur aplikohet dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivitetet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; njihet si fitim ose humbje për aktivitetet e klasifikuara si aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivitetet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

ii Ç' regjistrimi

Fondi c' regjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiv financiar.

Fondi nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferohen aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, aktivi ç' regjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivitetet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodatat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerësimit aktual neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

iv Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivitetet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivitetet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes

fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuara që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Shoqërinë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

vii. . Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative, të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me koston. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen me vlerën e tyre të drejtë. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që lidhen me investimet e disponueshme për shitje njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, dhe balanca në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse njihet në fitim ose humbje.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afat-shkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston të amortizuar.

• Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me koston të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

• Llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme nga letrat me vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të cilat përdoren në momentin e blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë janë njohur si aktive dhe detyrime në datën e transaksionit, datë e cila është e njëjtë me atë të pagesës.

e) **Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar.

4. STRATEGJIA E INVESTIMEVE TË ASETIVEVE TË FONDIT TË INVESTIMIT RAIFFEISEN PRESTIGJ.

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj mbështetet në ligjin nr 10198 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë.

4.1 Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Raiffeisen Invest sh.a i përmbahet ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve kolektive”, si dhe Prospektit të Fondit.

4.1.1 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- ✓ tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit European apo në ëdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- ✓ kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit European;
- ✓ depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në ëdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë së 12 muaj;
- ✓ instrumente financiare derivative ;
- ✓ instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumentave të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e riskut.

4.2 Politika e brendshme e investimit e shoqërisë administruese

Fondi synon të ketë një portofol të përqëndruar kryesisht në instrumentet borxhi të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Bonot e thesarit dhe obligacionet e qeverise shqiptare do te jene perberesit kryesore te ketij portofoli dhe pasha e tyre do te varioje ne funksion te kushteve te tregut si dhe politikave dhe strategjive te investimit te shoqerise administruese.

Pervec pjesemarrjes ne tregun sekondar te letrave me vlere, shoqëria administruese ka për qëllim të konkurrojë në mënyrë aktive në ankandet primare të bonove të thesarit dhe obligacioneve të organizuara nga Banka e Shqipërisë, në interesin më të mirë të investitoreve të Fondit.

Shoqëria e administrimit i kushton një rëndësi të vecantë shpërndarjes së aseteve, duke e konsideruar si vendimin kryesor në procesin e investimit.

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e synuar të aseteve të Fondit.

Klasa	Objektivi
Tituj të emetuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	90%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga shtete të BE-së	0%
Depozita bankare, marrëveshje të riblerjes (REPO), mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	6%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga autoritetet vendore dhe shoqëri tregtare të Republikës së Shqipërisë	2%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregëtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja	0%
Kuotat e fondit të investimit	2%
Derivate financiare	0%

Risku i investimit merret përsipër vetëm nga anëtarët e Fondit dhe jo nga shoqëria administruese. Për të minimizuar këtë risk, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një Komitet Investimi i cili propozon politikat e shpërndarjes së aseteve dhe të investimit dhe një njësi të Manaxhimit të Riskut që kryen kontrollin sasior e cilësor të të gjitha llojeve të risqeve që lidhen me Fondin e pensionit.

- **Vlera Neto e Aktiveve të Fondit Raiffeisen Prestigj**

Vlera e aktiveve neto është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

- **Vlera e kuotës së Fondit Raiffeisen Prestigj**

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 1000 Lekë, në përputhje me politikën e Fondit.

- **Të ardhurat nga interesat**

Të ardhurat nga interesat përfshijnë të ardhurat nga interesat e kuponave të obligacioneve dhe interesat nga depozitat. Të ardhurat nga interesat janë regjistruar sipas parimit të interesave të përlogaritura.

- **Tarifa për shoqërinë administruese.**

Fondi i detyrohet t'i paguajë shoqërisë administruese një tarifë prej 1.15 % (në bazë vjetore) të aktiveve neto, shpenzim për Fondin i cili përlogaritet në bazë ditore.

Fitim/ humbje të realizuara

Të ardhurat/humbjet e realizuara ndodhin për shkak të shitjes së letrave me vlerë me diferencë nga çmimi i ofruar me vlerën e principaleve dhe interesave të maturuara në letrat me vlerë të blera me premium ose discount. Këto fitim/humbje transferohen në të ardhura dhe shpenzime në momentin kur ndodhin.

- **Fitim/ humbje të porealizuara**

Fitim/humbje të porealizuara janë njohur si diferencë ndërmjet kostos dhe vlerës së drejtë të një letrë me vlerë. Kur letra me vlerë shitet vlera e fitim/humbjeve të porealizuara transferohet në fitim/humbje të realizuara të periudhës.

- **Transaksionet me palët e lidhura**

Palë të lidhura me Fondin konsiderohen ato palë të cilat kanë një influencë dhe kontroll në vendimet financiare dhe operacionale të Fondit.

Palë të lidhura me Fondin janë Raiffeisen Invest sh.a, e cila administron Fondin, Depozitari i cili kontrollon mirë-administrimin e Fondit si dhe Raiffeisen Bank sh.a. në cilësinë e aksionarit të Shoqërisë Administruese.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Fondin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional
- rreziku i shlyerjeve në shuma të mëdha
- rreziku rregullator
- rreziku i mos-diversifikimit
- rreziku i palës tjetër
- rreziku i performancës
- rreziku i inflacionit
- rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave
- rreziku i personelit kyç
- rreziku i vleresimit të asetëve

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Fondit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut.

Struktura e administrimit të rrezikut

Sipas ligjit nr.10198 datë 12 dhjetor 2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut. Në strukturën organizative, Drejtori i Menaxhimit të Riskut është përgjegjës për menaxhimin e rreziqeve.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria përmes standardeve dhe procedurave administrative synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse emetuesi i instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Fondi Prestigj është i ekspozuar ndaj këtij rreziku në rast se qeveria shqiptare has vështirësi në përmbushjen e shlyerjeve të detyrimeve të saj ndaj mbajtësve të letrave me vlerë të emtuara prej saj.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë:

	Letra me vlerë të tregtueshme	
	31 mars 2023	31 mars 2024
	Në lekë	Në lekë
Pa vonesa dhe të pazhvlërësuara		
Afatshkurtra: norma B (Shqipëria) sipas Standard & Poor's	22,843,054,025	26,770,776,797
	22,843,054,025	26,770,776,797

Rrezikut i normave të interesit

Është rreziku që i vjen vlerës së portofolit të fondit si pasojë e paparashikueshmërisë së levizjes së normave të interesit në treg. Më konkretisht, ky rrezik vjen si pasojë e lëvizjes në kah të kundërt të çmimit të instrumenteve dhe normave të tyre të interesit. Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiare bie, dhe anasjelltas. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiare, të cilët janë lirisht të tregtueshëm çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që asetet e Fondit të mos shiten në kohë dhe me vlerën e tregut si pasojë e mungesës së likuiditetit në treg. Në këtë rast Fondi mund të hasë vështirësi për të shlyer detyrimet financiare në kohën e duhur.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive, do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Rrezikut i kursit të këmbimit

Fondi nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës pasi transaksionet në monedhë të huaj nuk kane ndodhur.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë që vjen si rezultat i gabimeve njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose te dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, te vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Objektivi i Shoqërisë është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat kufizojnë ekspozimit ndaj këtij rreziku.

Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha krahasuar me madhësinë e fondit mund të ketë efekt negativ në performancën e Fondit, sepse mund të jetë i detyruar që të shesë një instrument financiar në mënyrë të parakohshme, çka mund të rezultojë në humbje dhe rënie të cmimit të kuotës.

Rreziku rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e asetëve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj.

Rreziku i mos-diversifikimit

Duke qenë se Fondi do të investojë kryesisht në Letra me Vlerë të Qeverisë, ai do të ketë një nivel të kufizuar diversifikimi dhe për rrjedhojë, mund të jetë më i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, politike, të biznesit ose të tjera që prekin emetues ose investime të ngjashme, krahasuar me një fond të diversifikuar. Kjo mund të rezultojë në një luhatje më të madhe të vlerës së kuotave të Fondit dhe rreziku i humbjes mund të jetë më i madh.

Rreziku i palës tjetër

Ky është rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Ai lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshjeje të paracaktuar, p.sh. mospagesën tek shitësi ose mosdorëzimin e objektit të marrëveshjes tek blerësi.

Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Rreziku i inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori, pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit, të jenë negative. Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai / ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Megjithatë, shoqëria administruese mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara në prospektin e fondit.

Rreziku i personelit kyc

Performanca e Fondit, pjesërisht i atribuohet aftësive profesionale të personave përgjegjës në shoqërinë administruese dhe vendimarrjes së duhur nga ana e administratorëve. Por, duke qenë se stafi i shoqërisë administruese mund të ndryshojë, vendimarrja e re mund të rezultojë më pak e suksesshme.

Rreziku i vlerësimit të asetëve

Ky lloj rreziku është tipik për tregjet jo likude ose për tregjet që përballen me kriza financiare dhe humbje të besimit. Nëse investitorët njëkohësisht kërkojnë të shlyejnë një numër shumë të madh kuotash në Fond, shoqëria administruese mund të jetë e detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i Fondit, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

6. TË TJERA

PARAJA DHE EKVIVALENTË TË SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	31 mars 2023	31 mars 2024
	Në lekë	Në lekë
Depozitë		914,000,000
Repo	1,588,594,882	1,880,983,388
Llogari rrjedhëse në banken FIB në Lekë	1,951,358,878	2,644,515,728
Totali	3,539,953,760	5,439,499,117

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme në Lekë janë detajuar si më poshtë:

	31 mars 2023	31 mars 2024
	Në lekë	Në lekë
Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
Te arkëtueshme nga interesi i depozites		242,586
Të arkëtueshme nga interesat e përlllogaritura të obligacioneve qeveritare	293,101,099	547,853
Te arkëtueshme nga interesi i Repos	246,840	207,879,740
Totali	293,347,939	208,670,179

Zv.Administratore e Përgjithshme

Alketa Emini

Kryespecialiste e Financës dhe Kontabilitetit

Ivana Karapici